

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	02 / 2022
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	15.04.2022

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive "KKS" - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS).

Takimi filloi në ora 10.00

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Halim Shehu - përfaqësues i Komunitetit Islam
Mikel Sopi - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
Fetije Bytyqi - përfaqësuese e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-ë
Refki Zogaj - përfaqësues i komunitetit të biznesit
Erolinda Zenelaj - përfaqësuese e mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Në takim munguan:

Rend dite

- 1. Miratimi Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e komunës së Suharekës;**
- 3. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer nga lufta;**
- 4. Informatë dhe diskutim për tejkalimin e gjendjes gjatë sezonit dimëror;**
- 5. Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve;**

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari - a ka vërejtje në procesverbal?, Nuk ka.

Aprovohet

Pika 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e komunës së Suharekës;

Kryetari - për këtë pikë, ia jep fjalën Komandantit të policisë z. Afrim Sylaj.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Sa i përket vjedhjeve në territorin e komunës së Suharekës krahasuar me tremujorëshin e vitit 2021 kemi ngritje të rasteve. Në statistikë kemi: vitin e kaluar kemi 41 vjedhje, këtë vit kemi 50 vjedhje të raportuara në polici. Zbulueshmëria e rasteve të vjedhjeve vitin e kaluar ka qenë 73 %, kurse këtë vit në tre mujorin e parë është 75.9 %. Kemi rritje të veprave penale, nga 186 raste që kanë qenë në tremujorin e vitit 2021, në vitin 2022 kemi 226 raste. Shqetësueset janë edhe rastet e dhunës në familje, ku kemi rritje. Në tremujorin e parë të viti 2021 kemi 16 raste, në vitin 2022 kemi 20 raste. Kemi rënje në falsifikimin e parasë, nga 10 raste, tani kemi 4. Në rastet e vjedhjes, faktorët që po ndikojnë dhe që i ka analizu policia janë: shtëpitë e braktisura ose shtëpitë e mërgimtarëve, dhe faktor tjetër është mosndëshkimi i kryerësve të veprave penale nga gjykata. Është mirë me qenë edhe një anëtar në KKSB nga gjykata ose prokuroria, me qëllim që edhe ai të jep pjesën e vet të përgjegjësisë, të raportojë para këtij këshilli. Vazhdimisht me rastet që jemi duke u marrë, kemi persona të komunave tjera që kryejnë vjedhje në komunën e Suharekës. Kërkoj nga të pranishmit dhe nga qytetarët që të rritet bashkëpunimi me policinë, të informojnë policinë për dyshimet që kanë në lagjet e tyre, me qëllim që të bëhet parandalimi me kohë i të gjitha dukurive negative.

Kryetari - ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me policinë dhe nëse bëjmë një krahasim me vitin e kaluar, situata është më e qetë.

Refki Zogaj - përshëndet të pranishmit. Desha të ju njoftoj që në Zonën Industriale në Shirokë është duke u punuar dhe kemi vendos disa sinjalistika, tabela dhe në të ardhmen ajo zonë besoj do të gjelbërohet. Kërkoj nga Komuna që në rrugën transitorie të bëhet pastrimi i mbeturinave.

Avni Bytyqi - mbas raportimit të komandantit të policisë u pa që kemi ngritje të rasteve të vjedhjeve, andaj dalim me rekomandim.

Rekomandim: Të rritet bashkëpunimi me qytetarëve dhe policisë, si dhe komunave dhe organeve tjera kompetente me qëllim të parandalimit të dukurive negative, me theks të veçantë vjedhjet.

Kryetari - a pajtoheni me këtë rekomandim?

Aprovohet

Pika 3. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer nga lufta;

Kryetari - i njofton me pikën dhe ia jep fjalën drejtorit të Arsimit.

Remzi Bjaselmani - përshëndet të pranishmit. Sa i përket kësaj teme, kemi përcaktuar disa shkolla ku është mbajtur trajnim nga ana e FSK-së. Kemi përcaktuar shkolla ku ka qenë rajoni ma afër zonave ku është pretendua që ka mjete të pashpërthyer. Fatmirësisht nuk kemi pas ndonjë rast të rrezikshëm deri më tani.

Kryetari - a ka mundësi edhe ma tutje me vazhdua, P.sh në viset malore ku kemi naj shkollë dhe kemi nevojë pak ma shumë. Ia japim fjalën përfaqësuesit të FSK-së.

Albestrim Rexhepi - përshëndet të pranishmit. Ne kemi ekipet tona të deminimit dhe jemi në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit. Do të punojmë që ti identifikojmë ato zona dhe ti mbajmë disa takime koordinuese në mënyrë që të arrijmë qëllimin. Vetëdijesimin e mjeteve piroteknike zakonisht e bëjmë para fundvitit.

Avni Bytyqi - kjo është edhe kërkesë e ushtrisë,që vazhdimisht të mbajnë ligjëratat përfaqësuesit e specializuar rreth çështjes së mjeteve të pashpërthyer.

Rekomandim: Drejtoria e Arsimit ta bëjë një kërkesë në ushtrinë e Kosovës për fillim e ligjëratave për mjetet e pashpërthyer dhe për mjetet e rrezikshme piroteknike.

Kryetari - a pajtoheni me këtë rekomandim?

Aprovohet

Pika 4. Informatë dhe diskutim për tejkalimin e gjendjes gjatë sezonit dimëror;

Kryetari - mendoj që këtë vit nuk kemi pas aq shumë borë sikurse vitet e kaluara. Jemi mundu vazhdimisht ti pastrojmë trotualet dhe sidomos rrugët në viset malore. Gjatë sezonit të dimrit Drejtoria e Shërbimeve Publike vazhdimisht ka qenë në teren, kur ka pas nevojë edhe natën. Këtë vit do të vazhdojmë me rregullimin e trotuareve ,do të shkojmë edhe nëpër fshatra.

Rekomandim: Edhe vitin e ardhshëm Komuna të jetë në gjendje gatishmërie për lidhjen e kontratave për pastrimin e borës dhe t'iu del ndihmë qytetarëve ku ka nevojë.

Kryetari - a pajtoheni me rekomandimin?

Aprovohet

Pika 5. Identifikimi dhe lirimi i hapsirave publike konkretisht trotuareve;

Kryetari - dy vite jemi përball me pandeminë dhe jemi mundu në çdo aspekt mi stimulu bizneset. Këtë vit është duke e punu një rregullore Drejtoria e Urbanizmit. Do ta bëjmë një vi dej ku ka mundësi,mirëpo trotualet duhet të jenë të lira për shkak të qarkullimit ma të lire të qytetarëve.Dhe qëllimi kryesor është sidomos nga 15 korriku deri 15 gusht dhe 15 dhjetor deri 15 janar,për shkak të festave të fundvitit dhe diasporës. Do të mundohemi edhe nëpër fshatra me kriju parkingje dhe trotuare.

Afrim Sylaj - sa i përket kësaj pike pjesën e vet të përgjegjësisë policia është duke e kry,pra largimin e gjësendeve nga trotualet dhe lirimi i zonave publike. Pjesa ku këmbësorët lëvizin,deri më tani 472 gjoba janë leshu janë ndalu me dhjetar makineri të ndryshme të cilat kanë qëndruar. Qyteti në përgjithësi ku lëvizin këmbësorët është liru. Kanë mbet 42 fshatra ti kryejmë në ditët në vijim sa i përket pjesës ku lëvizin këmbësorët. Nëse keni naj informatë ndonjëri prej anëtarëve për ndonjë veturë të braktisur që pengon lëvizjen e këmbësorëve,ne mundemi me intervenu menjëherë.

Kryetari - duhet me ja tërheq vërejtjen kompanisë, sepse nuk ka mundësi mi lan kerret nëpër rrugë, por le të gjej pllac dhe le ta kryejë punën e vet sepse kemi pas disa here ankesa dhe duhet me pas kujdes. Ju informoj që do të ketë një tollovi sepse sivjet do të bëhet impianti i ujrave atmosferikë dhe është një projekt shumë i madh. Këtë vit ende skemi fillu me punë për shkak se buxheti nuk është aloku. Jemi vonu shumë me punë pasi që veq po përfundon mujat e katër dhe ju e dini që në nëntor dhe dhjetor nuk punohet për shkak të ligjit që është në fuqi, dhe besoj që do të kemi probleme të mëdha. Kemi rrit të hyrat vetanake në komunën e Suharekës, kemi donacione. Këtë vit ndërtohen 15 shtëpi për familjet skamnore në bashkëpunim me shoqatën “Jetimat e Ballkanit”. Kemi donacion për shtëpinë me personat me aftësi të kufizuar nga kompania jonë publike, që i falënderoj. Kemi marrë donacion nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, ku do të bëhet mbikalim në Shirokë dhe gjithë ashtu shpresoj që komuna jonë të merr edhe një donacion nga performance e mire që kemi. Me datë 22 prill do të jetë një aksion i madh i pastrimit në gjithë territorin e komunës së Suharekës. Do të vazhdojmë me pastrimin e deponive ilegale dhe të gjitha deponitë ilegale pretendojmë mi shëndrru në fusha sportive parqe, lojra për fëmijë. Do të merret një vendim, aty ku ka deponi ilegale do të vendosim kamera të fshahta

Habibe Bytyqi - pasi po flasim për trotuaret, ndoshta është në rrjedhë edhe çështja e rrugës të qerdhja, sepse kanë vështirësi nënat që i qojnë fëmijët në qerdhe. Rekomandoj ta keni parasysh.

Kryetari - te qerdhja e fëmijëve ku është edhe Asambleja komunale vërtetë gjendja e rrugës është e keqe, por e dini si është gjendja e pronës. Para dy viteve kemi dasht me rregull me asfalt mirëpo nuk lejojnë një lagje e cila edhe me tutje konteston vendin në gjykatë.

Adem Dërguti - sa i përket trotuareve nëpër fshatra, p.sh: njerëzit punojnë, ndonjë kanalizim ose rrugë dhe e lënë ashtu. Dhe për 5 minuta ose 10 min. nuk e rregullojnë. Në çdo fshat shoh gjëra të tilla, gjë që duhet udhëheqja e fshatit mi bo e jo komuna.

Kryetari - ne procedura edhe ma tutje skemi fillu sepse nuk janë aloku mjetet dhe ka mundësi deri në qershor duhet me prit për mi krye këto punë. Nëse arrijmë me bo kompaninë tonë lokale atëherë do ta kemi shumë më të lehtë. Kryetari vazhdon tutje me sqarime.

Avni Bytyqi - ne në vitin 2021 e kemi rregullu me një akt nënligjor nga Kuvendi i Komunës dhe iu kemi kriju mundësinë ligjore që ata ta shfrytëzojnë hapësirën publike para lokaleve të tyre, sidomos bizneseve, por te çështja e lirit të trotuareve policia e tha që e kanë fillu aksionin. Mirëpo edhe nëpër gjithë territorin e komunës së Suharekës, edhe fshatrat ku pjesa e dërmuese janë me trotuare dhe, edhe ata kanë nevojë tu lirohen trotuaret. Por pse jo edhe inspeksioni ti vizitojnë bizneset nëpër fshatrat e tyre të cilët i kanë zënë hapësirat publike.

Rekomandim: policia dhe Drejtoria e Inspeksionit të marrin aksion muajin prill, të dalin dhe të bëjnë lirim të të gjitha hapësirave publike përreth lokaleve dhe trotuareve me qëllim që qytetarët të jenë të lirë me lëvizjen e tyre e me theks të veçantë qyteti i Suharekës, konkretisht rruga e Reshtnit, rruga e Shirokës dhe rruga “Xhavit Sylaj” në drejtim të Reqanit.

Kryetari - a pajtoheni me këtë rekomandim?

Aprovohet

Takimi përfundoi: **10:50**

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj